

FJALA E DEPUTETIT FLAMUR NOKA

E ENJTE 16 QERSHOR 2022

Zonja Kryetare.

Ajo që është shqetësuese në këtë parlament dhe në mbarëvajtjen e punimeve të tij, është konstatimi permanent se këtu po emërohet opozita dhe po përcaktohet vazhdimisht se cilit i jepet fjala dhe cilit deputet nuk i jepet fjala. Të emërosh opozitën, do të thotë që ti po varros demokracinë. Demokracia në këtë parlament nuk mund të varroset, zonja Kryetare.

Së dyti, që Kryeministri të mbajë flamurin dhe kjo qeveri të mbajë flamurin e antikorrupsionit, është njëlloj si të shohim ISISin që mban flamurin e luftës kundër terrorizmit. Ndaj këto fjalime bajate duhet t'i kursejmë dhe ju respektoni opozitën. Opozitën e kanë zgjedhur demokratët dhe nuk e kanë zgjedhur Edi Rama apo kabineti i tij. Tangot dyshe, që ka qejf t'i kërcejë shpesh Edi Rama, ka vende të tjera për t'i kërcyer, por jo këtu në parlament.